



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:267854
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05655213

KF.nr.472/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me Gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Mega Trans” Sh.P.K. me seli në rr. “Xh.Mitrovica”, 46/A, Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Behar Ejupi, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, me objekt kontesti kundërvajtje doganore, vlerë kontesti 2,346.10 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 26.04.2024 në prani të të autorizuarit të palës paditëse Avokat Behar Ejupi dhe të autorizuarit të palës së paditur Alberije Hoxha Dedushi, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Mega Trans” Sh.P.K. me seli në, Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.201/14 i datës 20.10.2017, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e parashtruar në gjykatë, me datë 05.12.20217, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit doganor dhe të Ligjit për Procedurën Administrative si dhe për shkak të

vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke kërkuar anulimin e pikës II, të dispozitivit të Aktvendimit nr.07.3./201 të datës 20.10.2017, i të paditurit Dogana e Kosovës, të hiqet kundërvajtja doganore për “Mega Trans” – Sh.P.K. Përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse gjatë seancës gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ke deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të ushtruar për Mega Trans duke i propozuar gjykatës të njëjtën ta aprovojë në tërësi si të bazuar si në padi. Ka shtuar se pas administrimit të provave qëndrojmë pranë pretendimeve se paditësi me rastin e paraqitjes së mallit për zhdoganim ka vepruar konform KDAK-së dhe se veprimet e paditëses janë në përputhje të plotë me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Andaj paditësja me veprime të saja nuk është përgjegjëse për kundërvajtjen e cila i është shqiptuar nga ana e të paditurës. Me propozim për gjykatën që padinë të aprovojë në tërësi dhe të hiqet kundërvajtja e shqiptuar për paditësen.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 13.04.2016 e ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit si të pa bazuar. Gjatë seancës gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar në dispozita ligjore pasi që aktvendimi i atakuar në padi në procedurën e rivendosjes është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që e paditura ka marrë për bazë rekomandimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë sipas aktgjykimit A.nr. 784/14 të datës 13.04.2017, ku ka vendosur sipas pikave të dispozitave të aktvendimit të atakuar, pasi që paditësi me asnjë provë materiale nuk ka arritur të dëshmojë se gjatë procedurës të zhdoganimit të mallit ka deklaruar sasinë dhe llojin e mallit si dhe e ka përfshirë tërë mallin e deklaruar. E paditura gjatë procedurës të zhdoganimit të mallit ka ekzaminuar mallin kontestues dhe ka bërë harmonizimin e të dhënave të deklaruara në deklaratë me atë të gjendjes faktike të mallit dhe nga aty ka konstatuar se paditësi nuk e ka deklaruar saktë sasinë, llojin e mallit si dhe nuk e ka përfshirë tërë mallin. Andaj me të drejtë konform dispozitave të KDA-nit 276 pika k) ka shpallur përgjegjës paditësin për kundërvajtje doganore dhe nga provat e administruara në këtë seancë rezulton se paditësi ka bërë deklaram të pasaktë të sasisë, të llojit dhe nuk e ka përfshirë tërë mallin dhe se aktvendimi i atakuar me padi është i drejtë dhe i ligjshëm duke i propozuar gjykatës që nga provat e administruara të refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke e lënë në fuqi aktvendimin kontestues si të drejtë dhe të ligjshëm.

Numri i lëndës: 2019:267854

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05655213

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në riprocedurë sipas Aktvendimit të Dhomave të Shkallës së dytë K.DH.SH.II.nr.265/22 të datës 21.06.2023, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 26.04.2024, ka administruar procesverbalin e datës 03.11.2020 për lëndën A.nr.2041/17.

Gjykata, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës duke vepruar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ - Divizioni Fiskal A.nr.784/14 të datës 13.04.2017, ka aprovuar pjesërisht kërkesën e subjektit këtu paditësit duke e ri-kualifikuar kundërvajtjen nga neni 276, pika a), e KDA-së nr. 03/L-109, në nenin 276, pika k), e këtij Kodi ashtu që ka hequr masën e konfiskimit të caktuar me aktvendimin nr.307/2014 të datës 11.02.2014, dhe ka lejuar kthimin e mjeteve për subjektin, këtu paditësin në vlerë prej 2,346.120 euro.

E paditura shqiptimin e gjobës administrative në lartësi prej 2,590.00 euro, ndaj paditësit, e ka bërë për shkak se paditësi nuk ka paraqitur mallin sipas aneksit 000947 të datës 11.02.2014, ngase me datën 09.02.2014, importuesi, këtu paditësi ka paraqitur për zhdoganim mallin tekstil, mirëpo Njësi AKQ 2 – gjatë kontrollës kanë gjetur se importuesi me anën të Deklaratës Unike Doganore R-3334 ka paraqitur mall më tepër se në vlerë prej 5867.50 euro dhe është gjetur mall i padeklaruar në vlerës prej 8,213.60 euro, diferenca në vlerë 2,346.10 euro, pra ka vepruar kështu me qëllim të shmangies nga taksat doganore në vlerë prej 647.52 euro. Ndërsa lidhur me lartësinë e gjobës e paditura si në vendim ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 03.11.2020, ka deklaruar se janë marrë parasysh të gjitha rrethanat me ndikim, dhe meqenëse i njëjti është recidivist i shqiptoi dënimin prej 2,590.00 euro.

Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Pretendimi i paditësi se në rastin konkret subjekti këtu paditësi "Mega Trans", Sh.P.K. nuk ka bërë farë kundërvajtje, dhe se kemi vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për Gjykatën është i pa bazuar dhe në kundërshtim edhe me shkresat e lëndës dhe atë me procesverbalin mbi kundërvajtjen administrative doganore nr.455 i datës 11.02.2014, dhe me DUD-in R3334/08.02.2014, për faktin se paditësi në bazë të shkresave si më lartë nuk rezulton të ketë paraqitur dhe deklaruar tërë sasinë dhe llojin e mallit me DUD-in nr3334, dhe atë në emërtimet 3,15,22,33 dhe 35 të kësaj deklarate, e që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e borxhit doganor në shumë prej 647.52 euro nga vlera e llogaritur e mallit prej 2,346.10 euro. Po ashtu nga vendimi kontestues, konstatohet se taksat doganore janë paguar në shumë prej 2,346.10 euro mall i cili është zhdoganuar përmes DUD-it R-3732/11 i datës 11.02.2014.

Gjykata nga shkresat e lëndës konstaton se nga e paditura gjatë ekzaminimit të DUD-it nr. 3334/08.02.2014, dhe atë në emërtimet 3,15,22,33 dhe 35, është gjetur mall si i deklaruar në mënyrë të pa saktë apo jo të plotë në kuptim të sasinë, llojit, apo të mos përfshirjes së tërë mallit, e që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e borxhit doganor në shumë prej 647.52 euro nga vlera e llogaritur prej 2,346.10 euro, e sanksionuar me dispoziten e nenit 276, pika k), e KDA-së, e cila përcakton se: "personi fizik apo juridik, *Në qoftë se, në Deklaratën Unike Doganore në mënyrë të rrejshme, të pasaktë apo jo të plotë shënon sasinë, cilësinë, llojin, kodin tarifor, vlerën apo origjinën e mallit ose nuk e përfshin tërë mallin, që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e borxhit doganor*

në shumë më të vogël nga ajo reale”, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) €,” .

Gjykata lidhur me lartësinë e gjobës së shqiptuar ka gjetur se e njëjta në kuptim të lartësisë nuk është kundërshtuar nga ana e palës paditëse, ndërsa në anën tjetër lartësia e gjobës është arsyetuar mjaftueshëm nga ana e palës së paditur në aktvendimin kontestues.

Gjykata vlerëson se nga gjendja faktike e vërtetuar si më lartë dhe bazuar në dispozitën e nenit 276, pika k), të Kodit nr. 03/L-109. Gjithashtu sipas Ligji nr. 04/1-099 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe të akcizave në Kosovë, nr. 03/1-109, neni 9, paragrafi 2, përcakton se *“Neni 276 i ligjit bazik, pas pikës z). shtohet pika e re: zh). me tekstin si në vijim: zh). për të gjitha shkeljet e parapara në nenin 276, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëqind (500) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro”,* është aplikuar si duhet e drejta materiale nga e paditura, duke dhënë arsye dhe sqarime të mjaftueshme në aktin e kundërshtuar.

Me nenin 43, par 1. të LKA-së, përcaktohet se: *“Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”,* andaj paditësi në këtë konflikt administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të ankesës, ashtu siç parashihet me nenin Neni 81 F paragrafi 1 dhe 81 E paragrafi 4, pika 4 dhe 5 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 .

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thënie e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës, gjykata e mori konform nenit 64 të LKA-së.

Numri i lëndës: 2019:267854

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05655213

Nga të cekurat më lart, Gjykata konform, nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.472/23 datë 26.04.2024

Gj y q t a r j a

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.